

Operacion policor në Prishtinë, arrestohen dhjetë persona të dyshuar

LAJME

LAJMI I FUNDIT

lajmi.net

Më afër lexuesit.

02/01/2023 09:51

f

tw

g

Policia e Kosovës ka bërë të ditur se dje më 1 janar rreth orës 17:15 kanë ndaluar dhe arrestuar dhjetë persona të dyshuar në rrugën “Vëllezërit Fazliu” në Prishtinë.

Personat e dyshuar janë arrestuar pas hetimeve rreth dy mujore të rastit të koduar me emrin “Përsëritësi”, pas dyshimeve se të arrestuarit janë të përfshirë në veprime të kundërligjshme, shkruan lajmi.net.

Gjatë operacionit policor është bastisur një shtëpi banimi në Prishtinë dhe janë kontrolluar pesë automjete, me ç’rast në cilësi të provave materiale janë sekuestruar dëshmitë:

- (96.6) gram substancë e dyshuar narkotike e llojit marihuanë
- (44.4) gram substancë e dyshuar narkotike e llojit kokainë
- (1) armë zjarri
- (2) karikator
- (17) fishek
- (358.8) para kesh (euro) të dyshuara të jenë fituar nga shitja e narkotikëve.
- (4) telefona celular
- (1) peshore digjitale

Pas kompletimit të rastit, me vendim të Prokurorit kujdestar, katër nga të dyshuarit janë dërguar në mbajtje, kurse të tjerët janë liruar në procedurë të rregull. **/Lajmi.net/**



Artikuj të ngjashëm

January 2, 2023

Kosova sfidohet nga qarkullimi i dinarit, Mehmeti flet për rritjen ekonomike:...

January 2, 2023

Tre fëmijë vazhdojnë të jenë në spital për shkak të lëndimeve...

January 2, 2023

Krasniqi s’pret marrëveshje të shpejtë në dialog: Afatizimin e ka shpikur...

January 2, 2023

I zhdukuri nga Deçani gjendet i vdekur

January 2, 2023

Një person lëndohet nga plumbi qorr në Prishtinë

January 2, 2023

Dhjetëra mijëra njerëz pritët të nderojnë ish-Papa Benediktin XVI

LAJME TË FUNDIT

Chelsea kërkon transferimin e Juranovic

Kosova sfidohet nga qarkullimi i dinarit, Mehmeti flet...

Tre fëmijë vazhdojnë të jenë në spital për...

Krasniqi s’pret marrëveshje të shpejtë në dialog: Afatizimin...